

UDHËZIM
Nr.14, datë 24.4.2009

**PËR KRITERET PËR ZGJEDHJEN E VENDEVE PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE NË FUSHATËN ZGJEDHORE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 3 pika 5, nenit 77 pika 1, nenit 78 pika 1 dhe 4, nenit 79 dhe nenit 88 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

Neni 1
Parime të përgjithshme

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë parimet dhe kriteret që duhen zbatuar për afishimin e materialeve propagandistike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 28.6.2009.

Neni 2

1. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore janë të detyruar për të gjitha vendet publike që do të caktojnë për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore, të përcaktojnë ndarjen e hapësirave në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

2. Caktimi i vendeve për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore bëhet publik dhe u njoftohet subjekteve zgjedhore jo më vonë se 15 ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

Neni 3
Caktimi i vendeve të afishimit

1. Në caktimin e vendeve publike, për afishimin e materialeve propagandistike, njësitë e qeverisjes vendore duhet të mbajnë parasysh:

- a) sheshet publike dhe afërsinë e tyre me qendrën e njësisë administrative përkatëse;
- b) rrugët kryesore;
- c) vendet e veçanta të caktuara për afishim;
- d) mundësinë e ndriçimit.

2. Për partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend, vendi dhe sipërfaqja për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore është 50% e sipërfaqes së caktuar, kurse për partitë e tjera parlamentare është 35% e sipërfaqes dhe partive joparlamentare, si dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit u caktohet 15% e sipërfaqes.

3. Brenda secilit prej grupeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni të ruhet barazia në shpërndarjen e vendeve për afishim, të vëna në dispozicion për çdo subjekt zgjedhor.

4. Çdo afishim i materialeve propagandistike jashtë vendeve publike të autorizuar sjell heqjen e tyre nga strukturat e zbatimit të ligjit, në varësi të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 4
E drejta e ankimit

1. Kundër vendimit të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, subjektet zgjedhore kanë të drejtën e ankimit në KQZ kur vërejnë pabarazi në sipërfaqe, në caktimin e vendeve për afishimin e

materialeve propagandistike zgjedhore.

2. KQZ-ja, kur konstaton shkeljet e pretenduara, urdhëron kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore për korrigjimin e pabarazisë në sipërfaqe për afishim të materialeve propagandistike.

3. Vendimi i KQZ-së për korrigjimin e pabarazisë në sipërfaqen për afishimin e materialeve propagandistike duhet të realizohet nga njësia e qeverisjes vendore përkatëse brenda 24 orëve nga marrja e tij.

Neni 5

Personat juridikë dhe fizikë

Personat juridikë apo fizikë, që ushtrojnë aktivitet në fushën e reklamave në vende publike në territorin e njësisë vendore përkatëse, janë të detyruar që të respektojnë parimet e barazisë në çmim për njësi sipërfaqeje dhe kohë ndërmjet subjekteve zgjedhore, në rastin kur afishojnë materiale propagandistike zgjedhore.

Neni 6

Sanksionet

Në rastet e kundërvajtjeve administrative, KQZ-ja vendos sanksionet administrative të parashikuara në Kodin Zgjedhor.

Neni 7

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ristani